**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

KAÇANIKU
**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**

**01Nr.04-60/01-2003/21**
**Kaçanik: 29.01.2021**

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 29 Janar 2021, pos tjerash u,

**INFORMUA**

1. Me Aktivitetin e zhvilluar të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës (DAK) - Për përfundimin e Periudhës së Parë të vitit shkollor 2020/2021, në bazë të dhënave të prezantuara në Informatën për përfundimin e Periudhës së Parë të vitit shkollor 2020/2021, e hartuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.

2. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese, është materiali më tekstin e mëtejmë: "Informatë për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit Shkollor 2020/2021", e përmbledhur në gjithsej : 22 faqe / Lënda: 01Nr. 04 Nr. 60/01-2003/21.

Më këtë Shkresë njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës;
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli
_______________

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

**Drejtoria e Arsimit dhe Kultures**
**04.Nr.** 60/01-2003/21
**Kaçanik**

# I N F O R M A T Ë

**Për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2020-2021**

**Kaçanik, Janar 2021**

## Përmbajtja:


1. Hyrje
2. Përgatitjet higjieno-teknike
3. Menaxhimi i pandemisë COVID 19
4. Skenarët e aplikuar A,B dhe C në kohë pandemie COVID 19
5. Investimet në infrastrukturën shkollore
6. Renovimet dhe përgatitjet e shkollave për vitin shkollor 2020/2021
7. Pajisen shkollat me 11 kabinete të reja
8. Furnizimi i shkollave me pajisje teknologjike informative/ Kompjuterë, Laptopë, Projektorë etj dhe gjeneratorë e kositëse bari
9. Angazhohen 20 mësimdhënës praktikant
10. Shlyerja e obligimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit
11. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimi parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)

11.1 Rrjeti shkollor

11.2 Suksesi i nxënësve, Arsimi Fillor (1 – 5)

12. Arsimi i Mesëm i Ulët (VI-IX)

12.1 Numri i nxënësve dhe suksesi i tyre në të dy nivelet 1 dhe 2 (I-V dhe VI –IX)

13. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të arsimtarëve
14. Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (X – XII)

14.1 Numri i nxënësve

14.2 Suksesi i nxënësve

15. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve

**Shkurtesat:**

- DAK- Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
- MASH- Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- MSh – Ministria e Shwndetwsisw
- PF- Parafillor ose niveli 0
- AF- Arsimi Fillor ose niveli 1 (klasa I-V)
- AMU- Arsimi i Mesëm i Ulët ose niveli 2 (klasa VI-IX)
- AML- Arsimi i Mesëm i Lartë ose niveli 3 (klasa X-XII)
- AJF- Arsimi Joformal

## 1. Hyrje

Viti i ri shkollor 2020 - 2021 ka filluar më 14 shtator 2020, sipas kalendarit shkollor të MASH-it, i hartuar në përputhje me rrethanat e krijuara si pasojë e pandemisë COVID 19, dhe sipas vendimit për fillimin e vitit të ri shkollor të ndarë në dy faza. Në fazën e parë janë përfshirë niveli parashkollor dhe klasat 1,2,3,6 dhe 10 sipas skenarit A (me prezencë në shkollë), ndërsa në shkollat tona kanë filluar edhe klasat 4 dhe 5, po ashtu sipas skenarit A, pra me prezencë në shkollë, pasi në të gjitha shkollat kishte hapësirë të mjaftueshme dhe në përputhje me vlerësimin e Task forcës në nivel të DKA-së dhe shkollave përkatëse.

Faza e dytë, ka filluar më 21 shtator, në të cilën fazë janë përfshirë klasat, 7, 8, 9, 11 dhe 12, po ashtu sipas skenarit A.

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës (DAK), edhe pse në kushte dhe rrethana jo të zakonshme, edhe për këtë vit shkollor pati filluar me kohë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/21, duke i respektuar në tërësi udhëzimet dhe vendimet e MASH e IKShPK për fillimin e mësimit në kushte pandemie.

Fillimisht është bërë planifikimi i regjistrimit të fëmijëve para fillor e atyre në klasat e para. Bazuar në raportet e 12 shkollave fillore amë, këtë vit shkollor janë regjistruar gjithsej 456 fëmijë para fillor të shpërndarë në 39 grupe, ndërkaq sivjet janë regjistruar gjithsej 490 fatosë në klasat e para të shpërndarë në 27 paralele. Po ashtu, është bërë edhe planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasat e X-ta, në 2 shkollat e mesme: në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka". Në Gjimnazin "Skënderbeu" sivjet janë regjistruar 187 nxënës , ndërsa ishin planifikuar 224 nxënës të ndarë në 7 paralele:

1. **Drejtimi Shkenca Natyrore,** 4 paralele me 97 nxënës të regjistruar
2. **Drejtimi Shkenca Shoqërore-Gjuhësore,** 3 paralele me 90 nxënës.

Ndërkaq, në SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" janë regjistruar gjithsej 163 nxënës në 11 paralele, ndërsa ishin planifikuar të regjistrohen gjithsej 312 nxënës të ndarë në 4 Drejtimet:

1. **Elektroteknikë me profilet:**
- Elektronikë industriale,
- Teknik i Informatikës
- Instalues Elektrikë me nga 1 paralele,

2. **Ekonomi me profilet:**
- Kontabilitet dhe tatime dhe
- Tregti me shumicë dhe Pakicë me nga 1 paralele,

3. **Makineri me profilet:**
- Instalues i ngrohjes e klimatizimit dhe ujësjellësit e kanalizimit (2 paralele),
- Trafik rrugor,
- Automekanik dhe
- Metalpunues, me nga 1 paralele dhe

4. **Juridik me profilin:**
- Juridik, administratë dhe shërbime të zyrës me 1 paralele.

## 2. Përgatitjet higjieno-teknike

Në të gjitha shkollat janë bërë përgatitjet higjienike e teknike, ndërkaq është bërë edhe dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore. Shkollat janë furnizuar me mjete higjienike si dezinfektues, sapun, e detergjentë të tjerë, ndërkaq për secilën shkollë janë siguruar edhe termometrat për matjen e temperaturës së nxënësve. Për të ndihmuar fillimin e vitit të ri shkollor MASH ka publikuar një dokument (Udhëzuesi i përgjithshëm për organizimin e mësimit në kushte të pandemisë COVID 19) me qëllim të organizimit të mësimit sipas skenarëve A dhe B dhe C, ku priorite është ruajtja e shëndetit të fëmijëve/nxënëseve, mirëqenies shëndetësore të qytetarëve si dhe realizimi i procesit edukativo

arsimor sipas kornizës së kurikulës së Kosovës, kurrikulave bërthamë për tre nivelet te arsimit parauniversitar, dhe plan-programeve mësimore/lëndore për secilën klasë në kushte të pandemisë COVID – 19.

Për fillimin e mbarë të vitit shkollor, në të gjitha shkollat janë themeluar edhe Task Forca, me qëllim të zbatimit të udhëzimeve dhe rekomandimeve të MASH dhe MSH. Task Forca e themeluar duke vepruar në përputhje me kompetencat e veta ka ndërmarr masat anti COVID 19 duke përfshirë edhe vendosur sistemin e komunikimit me prindër, nxënës, mësimdhënës e Task Forcën në nivel komune. Po ashtu, shkollat duke vepruar sipas udhëzimeve të MASH kanë përgatitur hapësirat e dhomave mësimore për numër të përgjysmuar të nxënësve për klasat me numër të madh nxënësish duke vendosur një nxënës në një bankë e po ashtu janë shenjëzuar hapësira e oborreve dhe hapësira e korridoreve për mbajtjen e distancës prej 1.5 metra, ndërkohë që janë ekspozuar edhe shumë poster me porosi se si të mbrohemi nga COVID 19 në ambientet shkollore etj.

## 3. Menaxhimi i pandemisë COVID 19

Në të gjitha shkollat janë bërë përgatitjet higjienike e teknike, ndërkaq është bërë edhe dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore. Dezinfektimi është bërë për çdo fundjavë nga stafi ndihmës i shkollave, ndërsa për çdo muaj vazhdon të bëhet dezinfektimi i tërësishëm nga një kompani e kontraktuar. Ndërkohë, shkollat janë furnizuar me mjete higjienike si dezinfektues, sapun, e detergjente të tjerë, ndërkaq për secilën shkollë janë siguruar edhe maska mbrojtëse e termometrat për matjen e temperaturës së nxënësve. Për të ndihmuar fillimin e vitit të ri shkollor MASH ka publikuar një dokument (Udhëzuesi i përgjithshëm për organizimin e mësimit në kushte të pandemisë COVID 19) me qëllim të organizimit të mësimit sipas skenarëve A dhe B dhe C, ku priorite është ruajtja e shëndetit të fëmijëve/nxënëseve, mirëqenies shëndetësore të qytetarëve si dhe realizimi i procesit edukativo arsimor sipas kornizës së kurikulës së Kosovës, kurrikulave bërthamë për tre nivelet te arsimit parauniversitar, dhe plan-programeve mësimore/lëndore për secilën klasë në kushte të pandemisë COVID – 19.
Për fillimin e mbarë të vitit shkollor në të gjitha shkollat janë themeluar edhe Task Forca, me qëllim të zbatimit të udhëzimeve dhe rekomandimeve të MASH dhe MSH. Task forca e themeluar duke vepruar në përputhje me kompetencat e veta ka ndërmarr masat anti COVID 19 duke përfshirë edhe vendosur sistemin e komunikimit me prindër, nxënës, mësimdhënës e Task forcën në nivel komune. Po ashtu, shkollat duke vepruar sipas udhëzimeve të MASH kanë përgatitur hapësirat e dhomave mësimore për numër të përgjysmuar të nxënësve për klasat me numër të madh nxënësish duke vendosur një nxënës në një bankë e po ashtu janë shenjëzuar hapësira e oborreve dhe hapësira e korridoreve për mbajtjen e distancës prej 1.5 metra, ndërkohë që janë ekspozuar edhe shumë poster me porosi se si të mbrohemi nga COVID 19 në ambientet shkollore etj.
Ndërkohë që DAK ka kërkuar angazhim më të madh të punëtorëve teknik në institucionet arsimore, me qëllim të mirëmbajtjes së pastërtisë së përgjithshme. Në funksion të kësaj, DAK është duke i stimuluar të njëjtit edhe me nga 60 euro shtesë për periudhën tremujore Tetor-Dhjetor 2020.

Edhe përkundër zbatimit të të gjitha masave anti COVID 19, megjithatë nuk kanë mbetur të paprekur as mësimdhënësit e punonjësit tjerë arsimor në Komunën e Kaçanikut. Numri i mësimdhënësve të infektuar me SARS-CoV-2, që nga fillimi i vitit të ri shkollor 2020-2021, është gjithsej 21, ndërkohë që të shëruar rezultojnë 18 prej tyre, ndërsa të infektuar gjatë kësaj periudhe janë edhe 5 punonjës tjerë arsimor, prej tyre 4 të shëruar dhe 5 nxënës, që të gjithë të shëruar.

Numri i mësimdhënësve, stafit tjetër e nxënësve të infektuar dhe shëruar që nga fillimi i vitit shkollor 2020-2021

| Shkolla | Mësimdhënës<br>të infektuar - të shëruar | | Stafë tjetër<br>të infektuar - të shëruar | | Nxënës<br>të infektuar – të shëruar | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjimnazi "Skënderbeu"- Kaçanik | 9 | 9 | 1 | 1 | 1 | 1 |
| ShMP "F.Guri dhe v. Çaka"- Kaçanik | 2 | 2 | 1 | 1 | | |
| ShFMU "Emin Duraku" - Kaçanik | 4 | 4 | 2 | 2 | 4 | 4 |
| ShFMU "Idriz Seferi" - Bob | 1 | / | 1 | / | / | / |
| ShFMU "Kadri Zeka" - Dubravë | / | / | / | / | / | / |
| ShFMU "Jusuf Gërvalla" - Biçec | 2 | 1 | / | / | / | / |
| ShFMU "Qamil Ilazi" – Kaç. Vjetër | / | / | / | / | / | / |
| ShFMU 'Nazmi Osmani" - Elezaj | 3 | 2 | / | / | / | / |
| ShFMU "Ali Asllani" - Doganaj | / | / | / | / | / | / |
| ShFMU "7 Shtatori" - Begracë | / | / | / | / | / | / |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ShFMU “Agim Bajrami” - Stagovë | / | / | / | / | / | / |
| ShFMU “Dituria” - Ivajë | / | / | / | / | / | / |
| ShFMU “Gafurr Luma” - Gllobоçicë | / | / | / | / | / | / |
| ShFMU “Naim Frashëri” - Kotlinë | / | / | / | / | / | / |
| /QEAP “Agimi” - Kaçanik | / | / | / | / | / | / |
| Gjithsej | 21 | 18 | 5 | 4 | 5 | 5 |

Me qëllim të përgatitjeve sa më të mira për fillimin e vitit të ri shkollor në kushte pandemie, në të gjitha shkollat janë mbajtur trajnime me mësimdhënësit për përdorimin e platformave digjitale, ndërkohë që me kohë janë siguruar edhe materiale tjera pedagogjike, ndërkaq, sikurse edhe viteve të më hershme, qeveria e vendit, përmes MASH dhe shtëpive botuese të kontraktuara, i kanë furnizuar falas nxënësit e tri niveleve, I-V dhe VI- IX dhe klasat parafillore.

## 4. Skenarët e aplikuar A,B dhe C në kohë pandemie COVID 19

Të gjitha institucionet arsimore, përkatësisht niveli 0 - parafillor, 1 –fillor, 2- i mesëm i ulët dhe 3 – i mësem i lartë kanë funksionuar sipas skenarit A, pra me prani fizike në shkollë me përjashtim të 2 Shkollave të Mesme të Larta që për një periudhë dy javore, të dyja shkollat, kanë zhvilluar procesin mësimor online/nga distanca.

Fillimisht ShMP “Feiz Guri dhe vëllezërit Çaka” pati kaluat në skenarin C nga 19.11.2020 – 30.11.2020, ndërsa janë rikthyer në skenarin A, që nga 2 nëntori e Gjimnazi “Skënderbeu” mësimin në distancë/ online e kanë filluar më 23.11.2020 – 04..12.2020, ndërkohë që në skenarin A janë rikthyer më 7 dhjetor 2020.

## 5. Investimet në infrastrukturën shkollore

**Përurohen 2 objekte të reja shkollore**

Komuna e Kaçanikut është angazhuar maksimalisht në krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e procesit mësimor dhe ngritjen e cilësisë në arsim. Segment i rëndësishëm është edhe ndërtimi i objekteve shkollore, zgjerimi i hapësirave dhe furnizimi me inventarë e mjete të nevojshme për funksionimin e institucioneve shkollore.

Vlen të theksohet se nxënësit e shkollës "Qamil Ilazi" në Kaçanik të Vjetër dhe ata të shkollës "Idriz Seferi", paralelja e ndarë në Kovaçec, gjatë këtij viti ( Periudha e Parë e vitit shkollor 2020-2021) mësimin e kanë nisur në objekte të reja. Të dy shkollat kanë hapësirë të mjaftueshme, ndërsa janë të ndërtuara me standarde bashkëkohore dhe moderne. Objekti shkollor në Kaçanik të Vjetër është financuar me mjete të MASH, e po ashtu ministria e ka bërë edhe furnizimin me inventar, ndërkaq objekti në Kovaçec është ndërtuar dhe financuar nga buxheti i komunës e po ashtu nga buxheti i komunës është bërë edhe furnizimi me inventarë shkollor. Ndërkohë, që kohë më parë ishin përuruar edhe 3 objekte shkollore: Në Glloboçicë, financuar nga MASh, në Ivajë, financuar nga mjetet buxhetore të Komunës së Kaçanikut dhe objekti i QEAP "Agimi" i financuar me fonde të BE-së përmes MASh. Ndërkaq, në Doganaj është në ndërtim e sipër objekti i ri shkollor i filluar sivjet.

## 6. Renovimet dhe përgatitjet e shkollave për vitin shkollor 2020/2021

**Investohen mbi 112 mijë euro**

Për mbarëvajtjen e vitit të ri shkollor, DAK kishte planifikuar të realizoj projektin infrastrukturor "Renovimi i infrastrukturës shkollore" për të cilin projekt janë shpenzuar nga buxheti i Komunës mbi 112 mijë euro (112,107 euro). Për shkak të procedurave të prokurimit, realizimi i këtij projekti është vonuar dhe për shkak të stinës së dimrit disa punë kanë mbet të kryhen në pranverë.

Renovime janë bërë në: Gjimnazin "Skënderbeu" në Kaçanik, ku projekti ka përmbajtë lyerjen /ngjyrosjen e brendshme të objektit dhe ndërrimi i dyerve të klasave e punë tjera teknike, ndërkaq në objektin e SHFMU "Kadri Zeka" në Dubravë është bërë rregullimi i ambientit të jashtëm, përkatësisht shtruarja e platos dhe shkallëve me kubëza betoni. Në infrastrukturën shkollore është investuar edhe në ShFMU "Jusuf Gërvalla" paralelja në Nikaj ku është rregulluar rrethoja e shkollës si dhe hapësira e jashtme dhe ri rregullimi i një klase e lyerja/ngjyrosja e sajë, ndërsa në shkollën amë në Biçec janë nderruar disa radiatorë për ngrohje me avull. Në SHFMU "7 Shtatori" në Begracë është bërë lyerja/ngjyrosja e brendshme e objektit dhe ndërrimi i disa dyerve të klasave, ndërsa në ShFMU "Idriz Seferi" në Bob është rregulluar rrethoja dhe një pjesë e oborrit të shkollës, e në paralelen e ndarë në Gajre është ndërtuar rrethoja dhe tereni sportiv dhe në paralelen tjetër fizike në Kovaçec, është punuar rrethoja e shkollës, oborri dhe ka mbete pa u përfunduar tereni sportiv për shkak të stinës së

dimrit. Në ShFMU "Emin Duraku", në Kaçanik në të dy objektet është bërë lyerja/ngjyrosja e brendshme, pastaj janë kryer punë hidrosanitare dhe janë nderruar disa dyer të klasave, ndërsa në ShMP " Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" është bërë lyerja/ngjyrosja dhe rregullimi i dyshemesë sikurse edhe në ShFMU "Gafurr Luma" në Gllobоçicë ku janë kryer disa punë në hapësirën e jashtme të objektit shkollor.
Investime janë bërë edhe në Qerdhen e fëmijëve "Agimi" në Kaçanik ku Organizata joqeveritare gjermane HELP ka dhuruar një donacioni në vlerë prej mbi 3 mijë euro që përmban shtretër për fëmijë, rafte druri dhe karrige.

Një projekt mjaft i rëndësishëm është realizuar me bashkëfinancim të Caritas-it zviceran dhe Komunës së Kaçanikut ku në 5 shkolla, janë pajisur me inventarë dhe mjete pune 5 klasë të nivelit parafillor, në vlerë të përgjithshme 12,500 euro (8,750 euro nga Caritasi dhe 3,750 participim i Komunës).

## 7. Pajisen shkollat me 11 kabinete të reja

Janë pajisur 6 shkolla fillore e të mesme të ulëta me 11 kabinete, 3 të Kimisë, 4 të Biologjisë dhe 4 të Fizikës.

Komuna e Kaçanikut, respektivisht DAK për realizimin e këtij projekti ka shpenzuar gjithsej 37,789 euro.

- ShFMU "Emin Duraku" në Kaçanik është pajisur me aparatura e mjete tjera e reagjentë për Kabinetin e Kimisë
- ShFMU "7 Shtatori" në Begracë është pajisur me aparatura e mjete tjera e reagjentë për Kabinetin e Kimisë
- SHFMU "Qamil Ilazi" në Kaçanik të Vjetër është furnizuar me pajisje e aparatura dhe reagjentë për Kabinetet e Kimisë, Biologjisë dhe Fizikës
- ShFMU "Agim Bajrami" në Stagovë është pajisur me aparatura e mjete tjera të ndryshme për kabinetin e Biologjisë dhe Fizikës
- ShFMU "Idriz Seferi" – Paralelja e ndarë fizike në Kovaçec, është pajisur me aparatura e mjete tjera të ndryshme për kabinetin e Biologjisë dhe Fizikës
- ShFMU "Gafurr Luma" në Gllobоçicë është pajisur me aparatura e mjete tjera të ndryshme për kabinetin e Biologjisë dhe Fizikës

## 8. Furnizimi i shkollave me pajisje teknologjike informative/ Kompjuterë, Laptopë, Projektorë etj dhe gjeneratorë e kositëse bari

Me qëllim të avansimit të cilësisë dhe me qëllim të aplikimit të metodave të reja, përditë e më shumë, edhe në shkollat e Komunës sonë është duke u aplikuar teknologjia informative.
Kohëve të fundit janë duke u futur në sistemin e arsimit pajisje kompjuterike që mundësojnë qasje të shpejt në informatat dhe mundësi të pafundme që ndihmojnë nxënësit të mësojnë dhe të jenë në trend me zhvillimet e kohës.
Andaj edhe këtë vit është bërë furnizimi me pajisje të reja të institucioneve arsimore përmes projektit "Furnizimi me pajisje teknologjike informative". Projekti ka përmbajt 48 kompjuter prej tyre 23 për institucionet arsimore, 17 Laptop prej tyre 15 për nevoja të Drejtorisë së Arsimit dhe shkollave dhe disa monitor, për të cilin projekt janë shpenzuar gjithsej afër 40 mijë euro (39,835 euro).

Përveç kësaj, ditë më parë, përmes UNMIK-ut shkollat janë pajisur edhe me 30 copë Tabletë/IPad, ndërkohë që edhe ELKOS për nevoja të shkollave tona kishte dhuruar ( Mini Laptop/Ipad, ndërkohe që edhe Kompania Bechtel-Enka dhuron 20 kompjuter për Shkollën Fillore " Idriz Seferi"- Kovaqec.

Një projekt tjetër ka qenë furnizimi i shkollave me 30 copë projektor, të cilët do të ndikojnë në rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, ndërkohë që mësimi do të bëhet më atraktiv e më interaktiv. Për realizimin e këtij projekti janë shpenzuar gjithsej 8,745 euro.

Disa nga shkollat e Komunës sonë janë pajisur dhe furnizuar më 7 copë gjeneratorë të llojit Dizel, 10 Kë, 3 fazor dhe 9 copë kositëse bari të llojit RM 248.0 (INT1), ndërsa për realizimin e këtij projekti janë shpenzuar 7,060 euro nga Buxheti i Komunës.

## 9. Angazhohen 20 mësimdhënës praktikant

Në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor në kohë pandemie, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës (DAK) me qëllim të mbarëvajtjes së procesit mësimor në kohë pandemie ka angazhuar 20 mësimdhënës praktikant për një periudhë 6 mujore, Tetor 2020 – Mars 2021, me mundësi vazhdimi. Mësimdhënësit janë të profileve të ndryshme si Mësues klasor, Gjuhë shqipe, Matematikë, Gjuhë angleze, Teknologji informative dhe Fizikë.

## 10. Shlyerja e obligimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit

Të gjitha obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë janë kryer për të gjithë puntorët arsimor për periudhën 18.04.2017 deri më 31.08.2020, ndërsa obligimet që dalin nga Kontrata e vitit 2014 janë kryesisht në procedura gjyqësore.

Prej vitit të kaluar dhe këtë vit, të gjthë mësimdhënësit kanë autorizuar avokat dhe kanë ngritur padi ndaj Komunës gjegjësisht DKA-së për moskryerje të obligimeve. Kanë qenë me qindra padi në gjykata , disa prej të cilave kanë përfunduar dhe janë ekzekutuar me përmbarues në favor të puntorëve arsimor.

Këtë vit janë ftuar të gjithë avokatët që kanë qenë të autorizuar nga puntorët arsimor dhe kemi arritur një Ujdi jashtëgjyqësore ashtuqë, nëse gjatë vitit 2020 i kryejmë të gjitha obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit nga data 18.04.2017 deri më 31.08.2020 bashkë me shpenzimet kontestimore, atëherë ata do t`i tërheqin paditë dhe do të hjekin dorë nga kërkesat. Ujditë jashtëgjyqësore të nënshkruara nga DKA dhe Avokatët janë realizuar 100% dhe janë tërhequr të gjitha paditë. Kostoja totale për shlyerjen e këtyre obligimeve ka qenë 676,301.88 euro për kategoritë e kompensimit dhe atë:

**a.** Në emër të kompensimit të ushqimit – shujtave, për ditët e pranisë në punë për periudhën 18.04.2017 deri me 31.08.2020.
**b.** Në emër të mësimit të kombinuar për periudhën 18.04.2017 deri me 31.08.2020.
**c.** Në emër të udhëtimit, 70 % të biletave të trafikut urban për periudhën 18.04.2017 deri me 31.08.2020 dhe
**d.** Në emër të shpërblimit jubilar deri më 18.04.2020

## 11. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimi parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)

Duke u bazuar në plan – programin për arsim parafillor dhe fillor, planin dinamik të punës, obligimet dhe përgjegjësitë e sektorit të arsimit në organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në Komunën e Kaçanikut, janë bërë të gjitha përpjekjet në bashkëpunim me shkollat dhe komunitetin për gjithëpërfshirjen e fëmijëve në arsimin parafillor dhe fillor dhe eliminimin e dobësive me qëllim të ngritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Rëndësi e veçant i është kushtuar zhvillimit dhe thellimit të dijes, kultivimit të identitetit personal, zhvillimit të përgjegjësive, aftësimit për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që fëmijët të krijojnë kushte për zhvillim të pavarur personal dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies së shoqërisë në përgjithësi.

Arsimit parashkollor (nivelit 0) për fëmijët e moshës pesë vjeç, edhe deri më sot, është trajtuar në mënyrë meritore duke iu kushtuar vëmendje e veçant. Në të gjitha shkollat amë funksionojnë paralelet parafillore, me përjashtim të asaj në Kotlinë, ku nuk është regjistruar asnjë fëmijë e kësaj grupmoshe.

Në nivelin 0 (parafillor) sivjet janë regjistruar gjithsej 473 fëmijë, prej tyre 450 në shkolla fillore e të mesme të ulëta të shpërndarë në gjithsej 39 grupe dhe 23 fëmijë të tjerë të përfshirë në QEAP “Agimi”. Nëse e krahasojmë numrin e fëmijëve të regjistruar sivjet me ata të

vitit të kaluar (472 fëmijë), atëherë del se sivjet në këtë nivel janë regjistruar pothuajse numër i njëjtë i fëmijëvë parafillor ( 1 më shumë se vitin e kaluar).

Përmes organizimit të këtij niveli shkollor synohet zhvillimi shoqëror, intelektual e fizik i çdo fëmije, e po ashtu synohet ushtrimi i rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimi i vlerave, si dhe përgatitja për arsimin fillor të çdo fëmiu.

Arsimi bazë përfshinë nivelet 1 dhe 2 apo arsimin fillor (1-5) dhe arsimin e mesëm të ulët (6-9). Përmes zhvillimit të arsimit bazë, Komuna e Kaçanikut synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë.

Arsimi i mesëm i lartë në Komunë e Kaçanikut zhvillohet në 2 shkolla të mesme. Përmes këtij niveli të arsimit, ne synojmë zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi, thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës. Politikat tona zhvillimore janë të orientuara në përfshirjen apo krijimin e mundësisë për çdo nxënës që përfundon arsimin bazë të regjistrohet në arsimin e mesëm të lartë. Po ashtu, jemi fokusuar në përfshirjen e numrit sa më të madh të nxënësve në drejtimet që ofron Shkolla e Mesme Profesionale "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" e po ashtu edhe në Gjimnazin "Skënderbeu".

### 11.1 Rrjeti shkollor

Në Komunën e Kaçanikut gjatë kësaj periudhe kanë funksionuar 12 shkolla amë, fillore e të mesme të ulëta dhe 11 paralele të ndara fizike, ndërkaq 4 nxënësit e paraleles së Gjurgjedellit e cila që nga shtatori i këtij viti shkollor (2020-2021) e ka ndërprerë funksionimin, kanë vijuar në shkollën "Idriz Seferi" ( një nxënës) dhe "Emin Duraku" (3 nxënës):

1. SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik me paralelet e ndara në Dushkajë, Runjevë dhe Kërbliq,
2. SHFMU "Idriz Seferi" në Bob me paralelet e ndara në Kovaçec e Gajre
3. SHFMU "Jusuf Gërvalla" në Biçec me paralelen e ndarë në Nikaj
4. SHFMU "Kadri Zeka" në Dubravë me paralelet e ndara në Vatë e Provoli
5. SHFMU "Ali Asllani" në Doganaj
6. SHFMU "Nazmi Osmani" në Elezaj me paralelen e ndarë në Bajnicë
7. SHFMU "Qamil Ilazi" me paralelen e ndarë në Fushë të Pajtimit
8. SHFMU "7 Shtatori" në Begracë

9. SHFMU “Agim Bajrami në Stagovë
10. SHFMU “ Gafurr Luma” në Glloboçicë
11. SHFMU “Dituria” në Ivajë me paralelen e ndarë në Shtrazë dhe
12. SHFMU “Naim Frashëri” në Kotlinë

Bazuar në kushtet dhe mundësitë mundë të konstatojmë se rrjeti i shkollave të nivelit AMU dhe AML është i kënaqshëm dhe ekzistojnë kushte relativisht të mira për zhvillimin normal të procesit mësimor. Në Komunën tonë gjatë Periudhës së Parë të këtij viti shkollor kanë funksionuar gjithsej 24 shkolla të nivelit fillor, të plota dhe jo të plota, ndërkaq, procesi mësimor për klasat VI-IX zhvillohet në 12 shkolla amë dhe në 5 paralele të ndara fizike.

**11.2 Suksesi i nxënësve, Arsimi Fillor (1 – 5)**

Në nivelin fillor, nga gjithsej 2430 nxënës sa ishin regjistruar në fillim të Periudhës së Parë, kanë vijuar gjithsej 2420 prej tyre, ndërsa sukses pozitiv kanë treguar 2402 nxënës, apo shprehur në përqindje 99.58 %. Me sukses negativ kanë ngelur 18 nxënës e 10 të tjerë nuk kanë vijuar ose janë çregjistruar.
Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2020 – 2021 prej 2430, me numrin prej 2433 sa ishin regjistruar një vit më parë (2019-2020), atëherë del se në këtë vit shkollor, në këtë nivel, janë regjistruar vetëm 3 nxënës më pak, ndërsa nota mesatare e këtij niveli arsimor është 4.10.

**Për më shumë të dhëna të nivelit I-V, shih Tabelën Nr. 1**

Suksesi në Arsimin Fillor (I - V) në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2020 - 2021

| | | | | | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | | TE PANOTUAR | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa | Gj.nxenes | | Vijojnë | | Shkelq. | | Sh.mire | | Mire | | Mjaft. | | Gj.pozitiv | | % | Me 1x1 | | Me 2x1 | | Me 3x1 | | Gj.negativ | | Nuk vijojne | | Te çregjistrua | | Nota mesatare |
| | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | |
| I | 475 | 234 | 475 | 234 | 300 | 166 | 90 | 42 | 66 | 19 | 17 | 7 | 473 | 234 | 99.58 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4.27 |
| II | 472 | 213 | 471 | 213 | 282 | 147 | 113 | 40 | 51 | 15 | 25 | 11 | 471 | 213 | 99.79 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 4.27 |
| III | 497 | 231 | 495 | 231 | 245 | 145 | 118 | 52 | 91 | 25 | 35 | 8 | 489 | 231 | 98.39 | 2 | 0 | 3 | 0 | 1 | 0 | 6 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 3.71 |
| IV | 483 | 239 | 478 | 237 | 211 | 132 | 113 | 56 | 114 | 44 | 37 | 5 | 475 | 237 | 98.34 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 5 | 2 | 3.98 |
| V | 503 | 231 | 501 | 229 | 231 | 132 | 123 | 56 | 93 | 25 | 37 | 15 | 494 | 228 | 98.21 | 4 | 1 | 0 | 0 | 3 | 0 | 7 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 3.94 |
| I-V | 2430 | 1148 | 2420 | 1144 | 1269 | 721 | 557 | 246 | 415 | 128 | 149 | 46 | 2402 | 1143 | 98.85 | 6 | 1 | 6 | 0 | 4 | 0 | 18 | 1 | 2 | 1 | 8 | 3 | 4.1 |

## 12. Arsimi i Mesëm i Ulët (VI-IX)

Numri i nxënësve në AMU në fillim të vitit shkollor 2020/2021 ishte 1910, prej tyre 963 femra, ndërsa nëse e krahasojmë me një vit më parë (gjatë vitit shkollor 2019-2020 ky numri i nxënësve ishte 1969), del se në këtë vit shkollor 2020/21, në këtë nivel janë gjithsej 59 nxënës më pak.

Nga numri i përgjithshëm prej 1910 nxënësve të nivelit AMU, kanë vijuar 1896 dhe janë vlerësuar me nota pozitive gjithsejt 1554 nxënës apo shprehur në përqindje 81.36 %, ndërkaq me nota negative kanë ngelur gjithsej 342 e 14 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë çregjistruar. Nota mesatare e këtij niveli arsimor del të jetë 3.66.

**Për më shumë të dhëna për nivelin VI-IX, shih Tabelën Nr. 2**

Suksesi në Arsimin e Mesëm të Ulët (VI - IX) në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2020 – 2021

| | | | | | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | | TE PANOTUAR | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa | Gj.nxenes | | Vijojnë | | Shkelq. | | Sh.mire | | Mire | | Mjaft. | | Gj.pozitiv | | % | Me 1x1 | | Me 2x1 | | Me 3x1 | | Gj.negativ | | Nuk vijojne | | Te çregjistr | | Nota mes |
| VI | 461 | 225 | 457 | 224 | 182 | 112 | 111 | 56 | 86 | 32 | 25 | 13 | 404 | 213 | 87.64 | 18 | 7 | 16 | 2 | 19 | 2 | 53 | 11 | 1 | 0 | 3 | 1 | 3.65 |
| VII | 495 | 247 | 493 | 245 | 170 | 116 | 109 | | 104 | 39 | 18 | 2 | 401 | 232 | 81.01 | 44 | 8 | 27 | 4 | 21 | 1 | 92 | 13 | 2 | 2 | 0 | 0 | **3.7** |
| VIII | 480 | 227 | 475 | 224 | 135 | 105 | 103 | 65 | 101 | 33 | 32 | 5 | 371 | 207 | 77.29 | 58 | 14 | 9 | 2 | 37 | 1 | 104 | 17 | 2 | 1 | 3 | 2 | **3.41** |
| IX | 474 | 264 | 471 | 264 | 157 | 119 | 110 | 73 | 85 | 40 | 26 | 8 | 378 | 240 | 79.75 | 42 | 18 | 22 | 2 | 28 | 4 | 93 | 24 | 0 | 0 | 3 | 0 | **3.58** |
| VI-IX | 1910 | 963 | 1896 | 957 | 640 | 452 | 433 | 269 | 376 | 144 | 101 | 28 | 1554 | 891 | 81.36 | 162 | 47 | 74 | 10 | 106 | 8 | 342 | 65 | 5 | 3 | 9 | 3 | **3.66** |

## 12.1 Numri i nxënësve dhe suksesi i tyre në të dy nivelet 1 dhe 2 (I-V dhe VI –IX)

Numri i përgjithshëm i nxënësve në këto dy nivele, të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2020/21 ka qenë 4340 (2111 femra) apo 78 më pak nëse e krahasojmë me numrin e nxënësve prej 4402 sa ishin një vit më parë (2019 – 2020). Nga numri i përgjithshëm, kanë vijuar gjithsej 4316 (2101 femra), ndërsa me sukses pozitiv janë vlerësuar 3956 (2035 femra) apo 91.15 %. Ndërkaq, me nota negative kanë mbetur 360 nxënës prej tyre 66 femra e 24 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë çregjistruar. Nota mesatare e përgjithshme e dy niveleve është 3.88.

**Për më shumë të dhëna për nivelin I-IX, shih Tabelën Nr. 3**

Suksesi sipas klasave I – IX në nivelin fillor dhe mesëm të ulët

| Klasa | Gj.nxenes | | Vijojnë | | Shkelq. | | Sh.mire | | Mire | | Mjaft. | | Gj.pozitiv | | % | Me 1x1 | | Me 2x1 | | Me 3x1 | | Gj.negativ | | Nuk vijojne | | Te çregjistrua | | Nota mesatare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | | | | | | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | | TE PANOTUAR | | | | |
| | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | |
| I | 475 | 234 | 475 | 234 | 300 | 166 | 90 | 42 | 66 | 19 | 17 | 7 | 473 | 234 | 99.58 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4.27 |
| II | 472 | 213 | 471 | 213 | 282 | 147 | 113 | 40 | 51 | 15 | 25 | 11 | 471 | 213 | 99.79 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 4.27 |
| III | 497 | 231 | 495 | 231 | 245 | 145 | 118 | 52 | 91 | 25 | 35 | 8 | 489 | 231 | 98.39 | 2 | 0 | 3 | 0 | 1 | 0 | 6 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 3.71 |
| IV | 483 | 239 | 478 | 237 | 211 | 132 | 113 | 56 | 114 | 44 | 37 | 5 | 475 | 237 | 98.34 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 5 | 2 | 3.98 |
| V | 503 | 231 | 501 | 229 | 231 | 132 | 123 | 56 | 93 | 25 | 37 | 15 | 494 | 228 | 98.21 | 4 | 1 | 0 | 0 | 3 | 0 | 7 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 3.94 |
| I-V | 2430 | 1148 | 2420 | 1144 | 1269 | 721 | 557 | 246 | 415 | 128 | 149 | 46 | 2402 | 1143 | 98.85 | 6 | 1 | 6 | 0 | 4 | 0 | 18 | 1 | 2 | 1 | 8 | 3 | 4.1 |
| VI | 461 | 225 | 457 | 224 | 182 | 112 | 111 | 56 | 86 | 32 | 25 | 13 | 404 | 213 | 87.64 | 18 | 7 | 16 | 2 | 19 | 2 | 53 | 11 | 1 | 0 | 3 | 1 | 3.65 |
| VII | 495 | 247 | 493 | 245 | 170 | 116 | 109 | | 104 | 39 | 18 | 2 | 401 | 232 | 81.01 | 44 | 8 | 27 | 4 | 21 | 1 | 92 | 13 | 2 | 2 | 0 | 0 | 3.7 |
| VIII | 480 | 227 | 475 | 224 | 135 | 105 | 103 | 65 | 101 | 33 | 32 | 5 | 371 | 207 | 77.29 | 58 | 14 | 9 | 2 | 37 | 1 | 104 | 17 | 2 | 1 | 3 | 2 | 3.41 |
| IX | 474 | 264 | 471 | 264 | 157 | 119 | 110 | 73 | 85 | 40 | 26 | 8 | 378 | 240 | 79.75 | 42 | 18 | 22 | 2 | 28 | 4 | 93 | 24 | 0 | 0 | 3 | 0 | 3.58 |
| VI-IX | 1910 | 963 | 1896 | 957 | 640 | 452 | 433 | 269 | 376 | 144 | 101 | 28 | 1554 | 891 | 81.36 | 162 | 47 | 74 | 10 | 106 | 8 | 342 | 65 | 5 | 3 | 9 | 3 | 3.66 |
| I-IX | 4340 | 2111 | 4316 | 2101 | 1909 | 1173 | 990 | 514 | 791 | 272 | 250 | 74 | 3956 | 2035 | 91.15 | 168 | 48 | 80 | 10 | 110 | 8 | 360 | 66 | 7 | 4 | 17 | 6 | 3.88 |

## Suksesi i nxënësve sipas shkollave prezantohet përmes Tabelës Nr. 4

| Nr. | shkoll. | gjithsej nxënës | | vijojnë | | SUKSESI POZITIV shkëlq | | shumë mirë | | mirë | | mjaft. | | gjithsej pozitiv | | % | SUKSESI NEGATIV 1x1 | | 2x1 | | 3x1 | | përsërisin | | Të Panotuar nuk vijojnë | | Cregjistrum | | nota mesatare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gj | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | Gj | F | % | Gj | F | Gj | F | Gj | F | Gj | F | Gj. | F | | | |
| 1 | "E.D" | **1394** | **677** | **1392** | **675** | **627** | **376** | **334** | **172** | **250** | **79** | **58** | **24** | **1269** | **652** | **91.16** | **65** | **15** | **31** | **4** | **27** | **4** | **123** | **23** | **2** | **2** | **0** | **0** | **3.9** |
| 2 | "K.Z" | 419 | 193 | 405 | 188 | 147 | 92 | 101 | 63 | 78 | 19 | 29 | 9 | 355 | 183 | **84.7** | 12 | 3 | 14 | 2 | 22 | 0 | 50 | 5 | 0 | 0 | 14 | 5 | **3.77** |
| 3 | "I.S" | 469 | 248 | 468 | 247 | 239 | 151 | 104 | 57 | 89 | 35 | 24 | 4 | 456 | 247 | **97.2** | 11 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 12 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | **4.02** |
| 4 | "J.G" | 288 | 143 | 287 | 143 | 134 | 87 | 64 | 33 | 57 | 16 | 20 | 6 | 275 | 142 | **95.48** | 3 | 0 | 0 | 0 | 9 | 1 | 12 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | **3.91** |
| 5 | "N.O. | 310 | 147 | 310 | 147 | 132 | 80 | 67 | 31 | 49 | 24 | 15 | 5 | 263 | 140 | **84.8** | 26 | 7 | 2 | 0 | 19 | 0 | 47 | 7 | 0 | 0 | 0 | 0 | **3.68** |
| 6 | "Q.I." | 421 | 210 | 418 | 209 | 187 | 120 | 87 | 43 | 60 | 20 | 16 | 5 | 360 | 190 | **85.51** | 29 | 13 | 9 | 3 | 20 | 3 | 58 | 19 | 3 | 1 | 0 | 0 | **3.94** |
| 7 | "A.A" | 319 | 146 | 317 | 145 | 144 | 83 | 62 | 29 | 48 | 20 | 35 | 9 | 289 | 141 | **90** | 13 | 4 | 13 | 0 | 2 | 0 | 28 | 4 | 0 | 0 | 2 | 1 | **3.89** |
| 8 | "7.Sh | 275 | 141 | 275 | 141 | 133 | 80 | 47 | 23 | 54 | 28 | 19 | 6 | 253 | 138 | **92** | 4 | 3 | 9 | 0 | 9 | 0 | 22 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | **3.84** |
| 9 | "G.L. | 149 | 71 | 149 | 71 | 61 | 36 | 29 | 17 | 39 | 15 | 20 | 3 | 149 | 71 | **100** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **3.81** |
| 10 | "A.B. | 162 | 74 | 162 | 74 | 57 | 34 | 57 | 24 | 36 | 10 | 5 | 2 | 155 | 70 | **95.68** | 5 | 3 | 1 | 1 | 1 | 0 | 7 | 4 | 0 | 0 | 0 | 0 | **3.81** |
| 11 | "Ditu | 102 | 45 | 101 | 45 | 36 | 24 | 27 | 14 | 24 | 6 | 8 | 1 | 101 | 45 | **100** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | **3.85** |
| 12 | "N.F" | 32 | 16 | 32 | 16 | 12 | 10 | 11 | 8 | 7 | 0 | 1 | 0 | 31 | 16 | **96.88** | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **4.18** |
| | gjith | 4340 | 2111 | 4316 | 2101 | 1909 | 1173 | 990 | 514 | 791 | 272 | 250 | 74 | 3956 | 2035 | 91.15 | 168 | 48 | 80 | 10 | 110 | 8 | 360 | 66 | 7 | 4 | 17 | 6 | 3.88 |

## 13. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të arsimtarëve

Në dy nivelet arsimore (I – IX), në këtë periudhë janë angazhuar gjithsej 375 arsimtarë (187 femra) prej tyre 152 në mësimin klasor dhe 223 në atë lëndor, ndërsa të kualifikuar rezultojnë të jenë 371 apo shprehur në përqindje 99.03 %. Nxënësit e këtyre dy niveleve, AF dhe AMU, përgjatë kësaj periudhe, kanë bërë gjithsejt 31773 mungesa prej tyre 24327 të arsyeshme, ose 7.32 orë për kokë nxënësi. Ndërkaq, mësimdhënësit gjatë këtij gjysmëvjetori kanë humbur 1062 orë mësimore ose mesatarisht nga 2.83 orë për arsimtarë.

**Për më shumë informata shih Tabelën Nr. 5**

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe mesme të ulëta

| Nr. | Emri I shkolles | KUADRI ARSIMOR | | | | | | | | | | | | mungesat e nxënësve | | mesat. për nx. | orët e pa mbajtura të arsimtarëv | mesatarja për arsimtarë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mësimi klasor | | | | Mësimi lëndor | | | | Dy ciklet | | | | | | | | |
| | | Gj | F | Kv | % | Gj | F | Kv | % | GJ | F | Kv | % | GJ | ARS. | | | |
| 1 | "Emin Duraku" | 42 | 39 | 41 | 97.62 | 47 | 22 | 46 | 97.87 | 89 | 61 | 87 | 97.75 | 8622 | 6229 | 6.18 | 130 | 1.46 |
| 2 | "Idriz Seferi" | 18 | 8 | 18 | 100 | 31 | 15 | 31 | 100 | 49 | 23 | 49 | 100 | 3034 | 2454 | 6.4 | 147 | 3 |
| 3 | "Kadri Zeka" | 20 | 10 | 20 | 100 | 16 | 7 | 16 | 100 | 36 | 17 | 36 | 100 | 4085 | 2881 | 8.99 | 48 | 1.33 |
| 4 | "Jusuf Gërvalla" | 12 | 9 | 12 | 100 | 19 | 6 | 19 | 100 | 31 | 15 | 31 | 100 | 6664 | 6274 | 21.78 | 188 | 6,0 |
| 5 | "Qamil Ilazi" | 14 | 8 | 14 | 100 | 18 | 8 | 18 | 100 | 32 | 16 | 32 | 100 | 3206 | 2910 | 7.59 | 167 | 5.06 |
| 6 | "Nazmi Osmani" | 10 | 9 | 10 | 100 | 16 | 7 | 16 | 100 | 26 | 16 | 26 | 100 | 1284 | 284 | 3.76 | 76 | 2.92 |
| 7 | "Ali Asllani" | 8 | 5 | 8 | 100 | 14 | 2 | 14 | 100 | 22 | 7 | 22 | 100 | 1335 | 1204 | 4.21 | 22 | 0.38 |
| 8 | "7 Shtatori" | 7 | 3 | 7 | 100 | 16 | 10 | 15 | 94.11 | 23 | 13 | 22 | 95.65 | 1261 | 224 | 4.58 | 19 | 0.82 |
| 9 | "G.Luma" | 5 | 3 | 5 | 100 | 8 | 2 | 8 | 100 | 13 | 5 | 13 | 100 | 469 | 374 | 3.11 | 6 | 2.16 |
| 10 | "A.B." | 5 | 3 | 5 | 100 | 11 | 2 | 11 | 100 | 16 | 5 | 16 | 100 | 1131 | 910 | 6.89 | 4 | 0.25 |
| 11 | "Dituria" | 8 | 4 | 7 | 87.5 | 16 | 3 | 16 | 100 | 24 | 7 | 23 | 95 | 516 | 436 | 5,05 | 96 | 4 |
| 12 | "Naim Frashëri" | 3 | 0 | 3 | 100 | 11 | 2 | 11 | 100 | 14 | 2 | 14 | 100 | 166 | 147 | 5.18 | 159 | 11.35 |
| | Gjithsej | 152 | 101 | 150 | 98.76 | 223 | 86 | 221 | 99.33 | 375 | 187 | 371 | 99.03 | 31773 | 24327 | 7.32 | 1062 | 2.83 |

## 14. **Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (X – XII)**

Edukimit dhe arsimimit në nivelin e Arsimit të Mesëm të Lartë (AML) i është kushtuar rëndësi e veçantë dhe përkujdesje e merituar, nga se pikërisht në këtë nivel merren hapat për të vazhduar studimet superiore, e po ashtu, edhe për përgatitjen profesionale të gjeneratave për tregun e punës.

Edhe në këtë nivel arsimor, synim kryesor është zhvillimi, zgjerimi dhe thellimi i dijes e njëkohësisht edhe kultivimi i identitetit personal, zhvillimi i përgjegjësive, aftësimit për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që nxënësit të përballojnë sfidat e jetës dhe të punës dhe integrimit më të lehtë të tyre në shoqëri.

### 14.1 Numri i nxënësve

Në këtë periudhë, të vitin shkollor 2020-2021 në dy shkollat e mesme janë regjistruan gjithsej 1158 (660 mashkuj dhe 498 femra) prej tyre 661 në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe 497 në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka". Në këtë vit shkollor, në dy shkollat e mesme janë regjistruar 99 nxënës më pak, krahasuar me vitin shkollor 2019/2020 që ishin të regjistruar gjithsej 1158 nxënës në dy shkollat.
Në kuadër të Gjimnazit "Skënderbeu" këtë vit mësimor kanë funksionuar 2 drejtime me po aq profile: Shkenca Natyrore dhe Shkenca Shoqërore-Gjuhësore, me gjithsej 24 paralele; 12 në njërin profil e 12 në tjetrin, ndërsa në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" kanë funksionuar 4 drejtime: 1. Elekroteknikë me profilet: Elektronikë industriale ( 1 paralele), Teknik i Telekomunikacionit (2 paralele), Teknik i Informatikës (3 paralele) dhe Instalues Elektrik ( paralele), 2. Ekonomi me profilet: Asistent marketingu ( 2 paralele), Kontabilitet dhe tatime (2 paralele) Tregti me pakicë dhe shumicë (2paralele) dhe Banka dhe sigurime ( 1 paralele), drejtimi i Makinerisë me profilet: Instalues i ngrohjes e klimatizimit dhe ujësjellësit e kanalizimit (2 paralele), Instalues i Ngrohjes Qendrore (2 paralele), Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit (2 paralele), Automekanik (3 paralele), trafik rrugor (2 paralele), Operator prodhimidhi (1 paralele) dhe Metalpunues ( 2 paralele).

### 14.2 Suksesi i nxënësve

Nga numri i përgjithshëm prej 1158 (498 femra) të regjistruar në fillim të vitit, mësimin e kanë vijuar gjithsej 1127 nxënës, prej tyre 492 femra, ndërsa sukses pozitiv kanë treguar 678 ose 58,54 %.
Me nota të pamjaftueshme kanë mbetur 449 nxënës ose 41.46 % prej tyre dhe të panotuar e të çregjistruar kanë mbetur gjithsej 31.

Suksesi i arritur reflekton vlerësimin e njohurive të arritura të nxënësve për këtë Periudhë të Parë të vitit shkollor 2020-2021, ndërkaq nota mesatare e nxënësve për dy shkollat e mesme del 3.06 dhe atë në Gjimnazin "Skënderbeu" 3.77 dhe SHMP "Feriz Guri dhe Vellezrit Çaka" 2.35.

**Për më shumë informata shih Tabelën Nr.6**

Suksesi në shkollat e Mesme të Larta në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2020/21

| Emri i shkollës | klasa | Të regjistruar | | Vijojnë | | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | | TË PA NOTUAR | | | | Nota mesatare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | shkëlq. | | sh.mirë | | mirë | | mjaft. | | Gjithsej pozitiv | | | 1X1 | | 1X2 | | Përsërisin me 3x1 | | Gjithsej negativ | | Nuk vijojn | | Të ç'regjistruar | | |
| | | Gj | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | % | Gj | F | Gj | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | |
| "Skënderbeu" | X | 180 | 99 | 179 | 98 | 41 | 25 | 57 | 39 | 28 | 17 | 1 | 0 | 127 | 81 | 70.95 | 28 | 13 | 17 | 4 | 7 | 0 | 52 | 17 | 0 | 0 | 1 | 1 | 3.64 |
| | XI | 217 | 135 | 216 | 135 | 78 | 60 | 58 | 44 | 32 | 16 | 0 | 0 | 168 | 120 | 77.78 | 31 | 10 | 6 | 2 | 11 | 3 | 48 | 15 | 0 | 0 | 1 | 0 | 3.88 |
| | XII | 264 | 150 | 263 | 150 | 75 | 60 | 81 | 51 | 60 | 28 | 2 | 0 | 218 | 139 | 82.89 | 26 | 8 | 12 | 3 | 7 | 0 | 45 | 11 | 0 | 0 | 1 | 0 | 3.78 |
| | **X-XII** | **661** | **384** | **658** | **383** | **194** | **145** | **196** | **134** | **120** | **61** | **3** | **0** | **513** | **340** | **77.96** | **85** | **31** | **35** | **9** | **25** | **3** | **145** | **43** | **0** | **0** | **3** | **1** | **3.77** |
| Sh.M.Profesion | X | 175 | 41 | 166 | 40 | 5 | 1 | 11 | 5 | 38 | 6 | 11 | 1 | 65 | 13 | 39.16 | 34 | 9 | 22 | 5 | 45 | 14 | 101 | 28 | 0 | 0 | 9 | 1 | 2.39 |
| | XI | 143 | 28 | 131 | 26 | 4 | 1 | 8 | 2 | 20 | 6 | 2 | 0 | 34 | 9 | 25.95 | 22 | 3 | 15 | 4 | 60 | 10 | 97 | 17 | 0 | 0 | 12 | 2 | 2.27 |
| | XII | 179 | 45 | 172 | 43 | 5 | 0 | 8 | 5 | 35 | 11 | 18 | 3 | 66 | 19 | 38.37 | 24 | 5 | 34 | 8 | 48 | 11 | 106 | 24 | 0 | 0 | 7 | 2 | 2.39 |
| | **X-XII** | **497** | **114** | **469** | **109** | **14** | **2** | **27** | **12** | **93** | **23** | **31** | **4** | **165** | **41** | **35.18** | **80** | **17** | **71** | **17** | **153** | **35** | **304** | **69** | **0** | **0** | **28** | **5** | **2.35** |
| Gjithsej | | **1158** | **498** | **1127** | **492** | **208** | **147** | **223** | **146** | **213** | **84** | **34** | **4** | **678** | **381** | **58.54** | **165** | **48** | **106** | **26** | **178** | **38** | **449** | **112** | **0** | **0** | **31** | **6** | **3.06** |

15. **Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në AML**

Vijimi rregullt i nxënësve është faktor i rëndësishëm në procesin mësimor që ka synim nxënien e diturive të reja.
Në fund të kësaj periudhe nxënësit e nivelit të AML-së kanë bërë gjithsejt 16859 mungesa (5662 nxënësit e Gjimnazit dhe 11197 ata të SHMP) prej të cilave me arsye 16859 ose 15.4 për kokë nxënësi. Ndërkaq, arsimtarët e nivelitë AML-së kanë humbur gjithsej 330 orë mësimi apo 3.56 orë mësimi për një arsimtar.
Kualifikueshmëria dhe ngritja profesionalizmi është kusht elementar dhe kyq për realizimin e suksesshëm të plan-programit mësimor dhe njëkohësisht është faktor për mësimdhënie e mësimnxënie të suksesshme. Kështu, në fillim të vitit shkollor në dy shkollat e këtij niveli janë angazhuar gjithsej 94 mësimdhënës (92 të kualifikuar ose 97,87%) prej tyre 41 në Gjimnazin "Skënderbeu" me shkallë të kualifikueshmërisë 97.56 % dhe 53 në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" prej të cilëve 52 të kualifikuar ose 98.11 %.

**Për më shumë informata shih Tabelën Nr.7**

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në shkollat e Mesme të Larta

**Tab.Nr.5**

| Nr. | Emri I shkollës | KUADRI ARSIMOR | | | | MUNGESAT E NXËNËSVE | | Mesatarja për nxënës | Orët e humbura të arsimtarëve | Mesatarja për arsimtarë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gj | F | KV | % | Gj | ARSYESHME | | | |
| 1 | "Skenderbeu" | 41 | 21 | 40 | 97.56 | 5662 | 3858 | 8,60 | 165 | 4.02 |
| 2 | SHMP | 53 | 16 | 52 | 98.11 | 11197 | 6543 | 22.21 | 165 | 3.11 |
| | Gjithsej | 94 | 37 | 92 | 97.87 | 16859 | 10401 | 15.4 | 330 | 3.56 |

Drejtori i Drejtorisë
Zahir Doda